



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.20

26 shkurt

2007

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i GJK nr.6, datë 16.2.2007	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.11, datë 11.2.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.....	343
Vendim i GJK nr.7, datë 19.2.2007	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.228, datë 19.4.2006 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën	345

VENDIM
Nr. 6, datë 16.2.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Alfred Karamuço	Anëtar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Kristofor Peçi	Anëtar	i	“	“
Kujtim Puto	Anëtar	i	“	“
Vjollca Meçaj	Anëtare	e	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Ploçi	Anëtar	i	“	“
Sokol Sadushi,	Anëtar	i	“	“

me sekretare Brunilda Bara, në datën 7.12.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.45/15 Akti që i përket:

KËRKUES: ASAMBLEJA E BANORËVE TË PALLATIT NR.10, TIRANË, përfaqësuar nga avokatët Mirjana Hoxha e Selfo Dosti, me prokurë.

SUBJEKTE TE INTERESUARA:

1. DOROTEA ZOTO, përfaqësuar nga avokatet Liljana Ruli e Evelina Qirjako, me prokurë.
2. AVOKATURA E PËRGJITHSHME E SHTETIT, përfaqësuar nga avokati i shtetit, Abaz Deda, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.11, datë 11.2.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesit, kanë parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit të sipërm:

- Nuk iu është komunikuar kërkesa për rishikim dhe se, në shqyrtimin e kësaj kërkesë, nuk janë thirrur nga gjykata;

- Subjekti i interesuar, Dorotea Zoto, nuk ka paraqitur provë të re që të vliente për rishikimin e vendimit.

Subjekti i interesuar, ka parashtruar:

- Çështja nuk mund të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese, pasi vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, për rishikim, nuk është vendim përfundimtar e për pasojë, kërkuesve nuk iu kanë shterrur mjetet, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës;

- Pretendimet e kërkuesve për rishikimin janë ezauruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku po zhvillohet gjykimi.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Alfred Karamuço, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjektit të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Midis kërkuesve, Asamblesë së Banorëve të Pallatit nr.10, Tiranë dhe subjektit të interesuar, Dorotea Zoto, si trashëgimtare e të ndjerit Guljelm Luka, është zhvilluar proces gjyqësor lidhur me një banesë, të cilën Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Tiranë, nuk ia ka kthyer Dorotea Zotos e trashëgimtarëve të tjerë, por është privatizuar në favor të kërkuesve.

Dorotea Zoto, ka kërkuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, shpalljen si të pavlefshme të kontratave të shitjes së apartamenteve kërkuesve, si dhe detyrimin e tyre për të njohur Dorotea Zoton etj., si pronarë.

Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.5851, datë 10.11.1997, ka rrëzuar kërkesën. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.956, datë 2.6.1998. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.54, datë 5.2.1999, nuk ka kaluar për shqyrtim gjyqësor rekursin e paraqitur nga Dorotea Zoto.

Dorotea Zoto, ka paraqitur pranë Gjykatës së Lartë, kërkesë për rishikim të vendimeve të mësipërme duke paraqitur disa dokumente, të cilat sipas saj, nuk ishin administruar në gjykimet e mëparshme.

Kërkuesit nuk kanë ardhur në dijeni për këtë kërkesë dhe as për faktin se ajo u shqyrtua nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pa pjesëmarrjen e palëve. Në përfundim, Gjykata e Lartë, me vendimin nr.11, datë 11.2.2005, ka vendosur pranimin e kërkesës për rishikim dhe prishjen e vendimeve nr.5851, datë 10.11.1997 të Gjykatës së Rrethit Tiranë; nr.956, datë 18.11.1998 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.54, datë 5.2.1999 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Gjykata Kushtetuese konstaton se ky vendim është rezultat i një procesi të parregullt gjyqësor, duke cenuar nenin 42/1 të Kushtetutës. Në një sërë vendimesh të Gjykatës Kushtetuese është pranuar se shqyrtimi i kërkesave për rishikim, në rastet kur ajo gjendet e bazuar, duhet realizuar duke zbatuar disa standarde siç janë: vënia në dijeni e subjekteve të interesuara për kërkesën e paraqitur, sigurimi i pjesëmarrjes së palëve në shqyrtim, garantimi i “barazisë së armëve” me qëllim që secilës palë t’i sigurohen mundësitë përkatëse që të parashtrijë argumentet e veta në gjendje të përshtatshme, etj.

Në rastin në shqyrtim, kërkuesit kanë ardhur në dijeni të prishjes së vendimeve të formës së prerë e të rishqyrtimit të çështjes vetëm kur Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, dërgoi lajmërimet për gjykim. Atyre nuk u është krijuar nga Gjykata e Lartë asnjë lloj mundësie që nëpërmjet pjesëmarrjes gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishikim, të parashtronin, në kushte të barabarta me palën tjetër prapësimet e tyre si dhe t’u garantohej mbrojtja e duhur ligjore.

Gjykata Kushtetuese gjithashtu nëpërmjet jurisprudencës së saj, i ka dhënë zgjidhje edhe problemit që u ngrit si pretendim nga subjekti i interesuar lidhur me moslegjitimitimin e kërkuesve për shkak të mosezaurimit të mjeteve të tjera të mbrojtjes ligjore, duke iu referuar nenit 131, shkronja “f” të Kushtetutës. Lidhur me një problem të tillë, Gjykata Kushtetuese është shprehur se “... në këto raste, edhe pse çështja kthehet për rigjykim dhe procesi gjyqësor vazhdon, në aspektin e shterrimit të mjeteve, ka rëndësi fakti se kërkuesi nuk ka mjet tjetër ankimi ndaj shkeljeve të pretenduara në instancën e fundit të gjykimit dhe se shqyrtimi gjyqësor rishtazi, nuk pretendon t’i ndreqë këto shkaqe, por të gjykojë çështjen në themel”.¹

Përsa i përket pretendimit tjetër të kërkuesve sipas të cilit, Dorotea Zoto nuk ka paraqitur në gjykatë dokumente të cilat sipas ligjit përbëjnë shkak për rishikim, Gjykata Kushtetuese nuk e merr në shqyrtim, sepse ai përbën një shkak që është tej kompetencave të saj për kontrollin kushtetues.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.11, datë 11.2.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë;

- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

¹ Vendimi nr.17, datë 18.7.2005 i Gjykatës Kushtetuese

VENDIM
Nr. 7, datë 19.2.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar	i	“	“
Fehmi Abdiu	Anëtar	i	“	“
Kristofor Peçi	Anëtar	i	“	“
Kujtim Puto	Anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Plloçi	Anëtar	i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“
Vjollca Meçaj	Anëtare	e	“	“

me sekretare Brunilda Bara, në datën 12.12.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.47/17 Akti që i përket:

KËRKUES: ALFRED LALA, përfaqësuar nga avokat Fariz Xhurxhi, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR: PROKURORIA E PËRGJITHSHME, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.228, datë 19.4.2006 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 33, 41, 42, 131, 132 dhe 133 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Kërkuesi, ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit të sipërm:

- Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, nuk ka bërë njoftim të rregullt lidhur me datën e shqyrtimit të çështjes, duke i penguar kërkuesit pjesëmarrjen dhe realizimin e mbrojtjes gjatë gjykimit;

- Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke zhvilluar gjykimin pa praninë e tij, ka zhvilluar proces të parregullt ligjor, pasi ka shkëlur parimin e barazisë së palëve në procesin gjyqësor;

- Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ka dalë jashtë juridiksionit të tij, sepse ka bërë vlerësim të ndryshëm të provave nga ai që kanë bërë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Bulqizë dhe Gjykata e Apelit Tiranë, si dhe ka shkëlur parimin e mosrëndimit të pozitës së të pandehurit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Vjollca Meçaj, përfaqësuesin e kërkuesit dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Me vendimin nr.40, datë 7.10.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë, kërkuesi Alfred Lala është deklaruar fajtor për veprën penale të kundërshtimit të punonjësit të Policisë, të Rendit Publik duke ushtruar dhunë dhe në bazë të nenit 236/2 të Kodit Penal është dënuar me 4 vjet burgim. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, gjykata ka urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit, duke e vënë të pandehurin në provë për një periudhë kohore 4-vjeçare.

Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.115, datë 25.2.2005.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbi bazën e rekursit të prokurorit, me vendimin nr.228, datë 19.4.2006, ka ndryshuar vendimet e mësipërme, duke hequr masën e pezullimit të zbatimit të vendimit, parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal, pa ndryshuar cilësimin ligjor të veprës penale dhe masën e dënimit të dhënë për të.

Kërkuesi kundërshton këtë vendim të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë duke pretenduar se njoftimi për datën e gjykimit nuk është bërë konform dispozitave ligjore, e për pasojë, ai nuk ka mundur të marrë dijeni për të, gjë që i ka penguar pjesëmarrjen dhe realizimin e të drejtës së mbrojtjes në gjykim.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se njoftimi i bërë jo në përputhje me ligjin, përfshihet në shqyrtimin kushtetues, vetëm kur pala ndërgjyqëse, për shkak të mosnjoftimit, është penguar të ushtrojë të drejtën e mbrojtjes, e cila i garantohet nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, si element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.

Në rastin konkret, Gjykata e Lartë, ka pasur në shqyrtim rekursin e paraqitur nga prokurori dhe kjo mbart në potencë mundësinë e përkeqësimit të pozitës së të pandehurit. Megjithëse organet e gjykimit nuk mund të bëhen përgjegjës për çdo mosparaqitje në seancë nga ana e të gjykuarit ose avokatit të tij, u takon këtyre organeve të ndërmarrin hapa për të siguruar që ai të gëzojë të drejtat e njohura nga Kushtetuta, siç është e drejta e mbrojtjes dhe barazia e armëve si element i saj përbërës.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se, në rastin në shqyrtim, Gjykata e Lartë, ka bërë njoftimin e datës së gjykimit të kësaj çështjeje me pasaktësi. Në shpalljen e afishuar publikisht, pranë asaj Gjykate, në kolonën përkatëse të rrethit, është shënuar “Dibër” në vend të “Bulqizë”, që në fakt i korrespondon emërimit real të gjykatës së faktit ku është zhvilluar gjykimi. Nga ana tjetër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duke zhvilluar gjykimin e çështjes pa verifikuar më parë shkaqet e mosparaqitjes së përfaqësuesit të të pandehurit, nuk ka ndërmarrë hapat e duhura për të siguruar që ai të gëzojë të drejtat e njohura.

Gjykata e Lartë në përgjigje të rekursit, nuk ka pasur të administruar asnjë argument ligjor të parashtruar prej palës së akuzuar dhe gjykimi është zhvilluar vetëm me argumente të paraqitura nga prokurori. Çështja vështirësohet dhe për arsyen se me paraqitjen e rekursit nga prokurori, Kodi i Procedurës Penale nuk parashikon mundësinë e paraqitjes së kundërrekursit nga pala kundërshtare. Në këto rrethana, pjesëmarrja e të gjykuarit dhe në mënyrë të veçantë e avokatit të tij, kërkohet për të siguruar të drejtën e mbrojtjes dhe respektimin e parimit të barazisë së armëve në një proces gjyqësor.

Rasti në shqyrtim ka ngjashmëri me çështje të tjera të shqyrtuara nga Gjykata Kushtetuese, prandaj referimi të vendimet e shpallura më parë, ajo e konsideron të domosdoshme për të konsoliduar qëndrimin e saj lidhur me këtë shkak. Në vendimin nr.24, datë 26.10.2005, kjo Gjykatë ka theksuar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk duhej ta zhvillonte gjykimin pa shqyrtuar dhe administruar shkaqet e mosparaqitjes së përfaqësuesit të të akuzuarit dhe pa i dhënë atij mundësi për të realizuar mbrojtjen ligjore. Gjykata Kushtetuese rithekson se, në aspektin e garantimit të procesit të rregullt ligjor, është detyrë e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, krijimi i kushteve dhe marrja e masave të nevojshme që seanca gjyqësore të zhvillohej në prani të avokatit, me qëllim që i gjykuari të mos preket nga pasojat e një procesi të zhvilluar pa pjesëmarrjen e avokatit të tij.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese çmon se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është i papajtueshëm me Kushtetutën, pasi është rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor, ku kërkuesit, i është shkelur e drejta e mbrojtjes. Kjo e drejtë, si një element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor, është e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Pretendimi se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka bërë vlerësim të ndryshëm të provave nga ai që kanë bërë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Bulqizë dhe Gjykata e Apelit Tiranë dhe se ka shkelur parimin e mosrëndimit të pozitës së të pandehurit, Gjykata Kushtetuese nuk e gjen të bazuar. Nga materialet e çështjes rezulton se Gjykata e Lartë nuk ka bërë vlerësim të ri të provave që lidhen me zgjidhjen e çështjes. Ajo ka bërë interpretimin e nenit 59 të Kodit Penal dhe rastet e zbatimit të tij, duke i lidhur këto me çështjen në shqyrtim, gjë që përfshihet në juridiksionin e saj.

Nga sa u parashtrua më lart, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, duhet shfuqizuar si i papajtueshëm me Kushtetutën.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 132 të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.228, datë 19.4.2006 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë;

- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot", Tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. **KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
2. **KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
3. **REGJISTRAT E NOTERISË**
4. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**
 1. **PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006) 1500**
 2. **PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) 600**
 3. **PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)..... 1300**
 4. **PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT..... 500**

BOTIME TË REJA

1. **TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000**
2. **TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500**
3. **TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000**
4. **TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500**
5. **PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË..... 1000**
6. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR..... 800**
7. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET..... 500**
8. **PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)..... 1000**
9. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE..... 500**

Hyri në shtyp më 26.2.2007
Doli nga shtypi më 26.2.2007

Tirazhi: 3500 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Grafon"
Tiranë, 2007

Çmimi: 8 lekë